



**HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A**  
**BORDI I DREJTORËVE**

**Nr. I/203**

**Datë: 26.12.2024**

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 16, të mbajtur më 26.12.2024, njëzëri mori këtë

**VENDIM**

Për plotësim-ndryshime në Rregulloren mbi Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës të HK-Trainkos Sh.A, Nr. I/130 të datës 29.08.2024 si në vijim:

- I. Në Nenin 16, për pozitën Zyrtar i Kontrollit të Shitjes dhe Matjes së Kënaqshmërisë së Klientëve, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduara studimet universitare, e preferuar në njërën nga këto fusha apo drejtime: Ekonomike, Juridike, Administrim Biznesi, Marketing si dhe fusha tjera të ndërlidhura me pozitën”.
- II. Në Nenin 25, për pozitën Zyrtar i Personelit, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduara studimet universitare, e preferuar në njërën nga këto fusha apo drejtime: Ekonomike, Juridike, Administrim Biznesi, Marketing si dhe fusha tjera të ndërlidhura me pozitën”.
- III. Në Nenin 49, për pozitën Agjent i Marketingut, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduara studimet universitare, e preferuar në njërën nga këto fusha apo drejtime: Ekonomike, Juridike, Administrim Biznesi, Marketing si dhe fusha tjera të ndërlidhura me pozitën”.
- IV. Në Nenin 50, për pozitën Agjent për Oferta, Hulumtimin e Tregut dhe Monitorimin e Çmimeve për Transportin e Mallrave, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduara studimet universitare, e preferuar në njërën nga këto fusha apo drejtime: Ekonomike, Juridike, Administrim Biznesi, Marketing si dhe fusha tjera të ndërlidhura me pozitën”.
- V. Në Nenin 51, për pozitën Agjent për Oferta, Hulumtimin e Tregut dhe Monitorimin e Çmimeve për Transportin e Udhëtarëve, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduara studimet universitare, e

preferuar në një të një nga këto fusha apo drejtime: Ekonomike, Juridike, Administrim Biznesi, Marketing si dhe fusha tjera të ndërlidhura me pozitën”.

- VI. Në Nenin 52, për pozitën Agjent për Promocion në Rrjete Sociale, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduara studimet universitare, e preferuar në fushën e ekonomisë, teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike apo gazetari dhe komunikim, Administrim Biznesi, Marketing si dhe fusha tjera të ndërlidhura me pozitën”.
- VII. Në Nenin 58, për pozitën Zyrtar Administrativ në Transportin e Udhëtarëve, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm apo studimet universitare”.
- VIII. Në Nenin 67, për pozitën Dispeçer i Mjeteve Tërheqëse dhe të Tërhequra në Transportin e Udhëtarëve, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, pika a) riformulohet si në vijim: “Të ketë të përfunduar Shkollën e Mesme Profesionale - drejtimi Hekurudhor - Teknik i Tërheqjes së Trenave, apo Teknik i Komunikacionit”.
- IX. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Arsyetim:** Bazuar në kërkesën e Menaxhmentit për plotësim-ndryshime të kësaj rregulloreje dhe arsyetimeve se këto ndryshime do të ndikojnë në krijimin e një strukture më të qëndrueshme dhe efikase për menaxhimin e burimeve profesionale njerëzore në Ndërmarrje, Bordi i Drejtorëve ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi. Përmes këtij vendimi, ndryshimet përfshijnë plotësim-ndryshimet në kualifikimet për disa pozita, të cilat u vlerësuan të arsyeshme duke krijuar mundësinë që në këto pozita të mund të sistemohen të punësuarit edhe nga disa fusha tjera të përgatitjes profesionale që i përgjigjen përshkrimit dhe detyrave për vendin përkatës të punës.

**Të bashkëngjitur me këtë vendim janë këto dokumente:**

- Raporti i Komisionit për plotësim-ndryshime të Rregullores mbi Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës nr. I/130 datë 29.08.2024;
- Opinioni i Zyrës Ligjore të Ndërmarrjes;
- Kërkesa e Menaxhmentit për plotësim-ndryshime.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues



**Iu dërgohet:**

- Menaxhmentit të HK-Trainkos Sh.A
- Aksionarit – NJPMNP
- Arkivit